



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRISHTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 16961/10

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, GJYQTARI Ali Latifi, me pjesmarrjen e sekretarës juridike Shemsije Lumi, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Enver Hamiti nga Prishtina, për kundërvajtjen nga neni 16.paragafri 1.1. të Ligjit për deklarativin e prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, e në bazë të nenit 73,74,195, dhe neni 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet me dt. 30.06.2010, me këtë,

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Enver Shaip Hamiti i lindur me 07 shkurt 1965 në Gjilan tani me vendbanim në Prishtinë rr "Bregu Diellit" zona lindjës nr 14/7, me profesion ingjinjer, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike deri më tani i pa denuar.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse me dt.22.03.2010, si Zyrtar i Lartë Publik është punësuar në Fakultetin e Elektros, dhe nga Agjensioni për antikorrupsion nuk e ka dërguar formularin për deklarimin e pasurisë edhe pse i janë dërguar formularët e Agjensionit për Antikorrupsion, në formë fizike dhe në elektronike.

Me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 16.paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, andaj për këtë

G j O B I T E T

Me gjobë në shumë prej 1000 (Njëmijë) Euro, të cilën gjobë kanë për të paguar në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktvendim të mere formën e prerë, në dobi të AFQ I Drejtësisë në Prishtinë xhir.rjedhëse 1000-4300-70000-518. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do të zavendosihet me denim burgu në kohëzgjatje prej 30 (Tridhjet) ditësh, duke u, a llogaritur nga 15 euro, në ditë burgu.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur, kurse në emër të paushllit gjyqësor I pandehuri është i obliguar të paguajnë shumën prej nga 5 euro në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Pagesa e gjobës dhe paushllit gjyqësor mund bëhet në gjykatën komunale për kundërvajtje në Prishtinë.

Nga një kopje të këtij aktvendimi t, u dërzohet të të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtror gjykatës kërkesë nr 01-2311/10 të dt. 08.06.2010, për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të përmendur më lartë dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtari inicoi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të të pandehurit i cili deklaroi: ne kemi marrë këtë por nuk e kemi plotësuar, sepse ne kemi shqyrtuar këtë rast pos informatës që kemi marrë nga sekretarja e Fakultetit dhe pastaj kemi kërkuar nga Rektorati që Rektorati të na përgjigjet me shkrim se si duhet të veprohet dhe cilat janë obligimet tona ligjore, ashtu siq e parashf ligji ne nuk kemi marrë kurrfar përgjigje nga Rektorati i Universitetit dhe unë personalisht nuk kam mundur që këto ti dërgoj sepse kto raporte nuk i ka plotësuar askush nga fakulteti jonë.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjykata ka marrë në pyetje përfaqësuesit e Agjencionit Kundër Korrupsionit të cilët ofruan dëshmi të mjaftueshme me dt. 30.06.2010, se i pandehuri për kunders marrjes së materialit për plotësim dhe informim të organeve kompetente për kontrollimin e pasurisë dhe prejardhjes të zyrtarëve të lartë, si dhe dhuratave zyrtare që është përcaktuar në nenin 3 të Këtij ligji të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i njëjti këtë nuk e ka bërë, andaj kërkojmë që gjykata të vepron sipas kërkesës dhe ligjit që është në fuqi.

Me rastin e shqiptimit të denimit, gjyqtari vlersoi të gjitha rrethanat nga neni 7 të LMK-së, nën të cilat është kryer kundërvajtja dhe të pandehurit I, u shqiptua ky lloj denimi, duke llogaritur se edhe me këtë do të arrihet efekti pozitiv i sanksionimit, që i pandehuri në të ardhmen t, shmangët kryerjes së veprave të këtilla dhe të ngjajshme.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi ankesë mund të ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi nëpërmes të kësaj Gjykate pa taksa.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJYQTARI
Mr.Sc. Ali Latifi